REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 25/17
Datë/Datum. 28.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH Nr. 25/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Hib Petrol" Sh.p.k – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Karburante'', me nr prok: AQP "/16/001/111'' iniciuar nga autoriteti kontraktues /Agjencia Qendrore e Prokurimit/ (AQP) më datën 16 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** pjesërisht si e bazuar ankesa e OE "Hib Petrol" Sh.p.k – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Karburante''me nr prok: AQP "/16/001/111'' iniciuar nga autoriteti kontraktues /Agjencia Qendrore e Prokurimit/.

II. **Anulohet,** njoftimi për kontratë i AK- /Agjencia Qendrore e Prokurimit/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Karburante'', me nr prok: AQP"/16/001/111''111'' iniciuar nga autoriteti kontraktues /Agjencia Qendrore e Prokurimit/ (AQP) dhe lënda kthehet në ritenderim, nëse edhe më tutje ka interes autoriteti kontraktues për këtë procedurë prokurimi.

III. Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar.

IV. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:01.12.2016 .

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Hib Petrol" Sh.p.k – Prishtinë është bërë me dt:19.01.2017.

Vendimi në lidhje me kërkesën për rishqyrtim është marr me dt:20.01.2017, ku i është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.

Operatori ekonomik "Hib Petrol" Sh.p.k – Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 23 janar 2017 me nr. protokolli 25/17, kundër njoftimit për kontratë të AK-së, përkitazi me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Karburante''me nr prok. AQP "/16/001/111''duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LP04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelej e nenit 28 të LPP-së, Specifikimet teknike;
- Shkelje e nenit 30 të LPP-së, Nën-kontraktimi;
- Shkelje e nenit 71 të LPP-së, Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorëve e Huaj Ekonomik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës 06 shkurt 2016, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të **aprovohet** si pjesërisht e bazuar , ndërsa të **aprovoj** vendimin e autoritetit kontraktues njoftimin për kontratë, të datës 1 dhjetor 2016

Operatori ekonomik ankues me datë 10 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues me datë 07 dhjetor 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16. 02. 2017, ku kanë qenë prezent, paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues dhe vëzhguesit e OJQ-së "D Plus", ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Hib Petrol" ka deklaruar: Bazuar në tenderin me vlerë të madhe, dhe kriteret të cilat jo të ngarkuara por janë të mangëta bazuar në nivelin e aktivitet të prokurimit, AK ka krijuar një monopol i cili është përdor nga OE-të. Kriteret të cilat nuk përmbajnë as gjëra elementare për furnizim me derivate të naftës, kanë krijuar kompani të quajtura Fantom, të cilat për shkak kritereve që nuk janë kërkuar ja kanë mundësuar krijimin e një monopoli prej një kompanie të vetme.

Këtë e bazojmë në të gjeturat në teren ku sub-kontraktorët e tonë na kanë njoftuar se e njëjta kompani ka përgatitur dokumentacion për dy ose më shumë kompani pjesëmarrëse në këtë aktivitet. Sipas informatave në terren veç se ofertat kanë qenë të dorëzuara në AQP njëzet ditë para kohe. Duke pa këtë shqetësim, para edhe marrjes së ndryshimeve të dosjes së tenderit, dokumentacioni veç ka qenë i dorëzuar i OE-ve.

Kemi tentuar ta adresojmë shqetësimin pranë AK-së dhe kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, dhe është kthyer negativ. Të njëjtën gjë kemi përdor sipas ligjit dhe ankesën në OSHP. Në ankesën tonë specifikohet se kanë qenë të obligueshme shtimi i disa kritereve për mos lejimin e këtij monopoli të jashtëm sepse nuk është kërkuar as referenca, as kontrata, as qarkullim financiar, as mjete transportuese, dhe disa licenca tjera që janë të domosdoshme për shërbime të naftës të cilat kompanitë që kanë dorëzuar ofertën është dashtë me i pas. Këto kërkesa nuk janë monopoliste mirëpo do eliminonin monopolin veç se për të krijuar dhe të dorëzuar në AQP.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesi i AK-AQP ka deklaruar: Ne pajtohemi me raportin e ekspertit shqyrtues. Konsiderojmë se kriteret janë në përputhje me LPP-në. Për çështjen e monopolit apo marrëveshje të fshehta, kushdo që ka informacione për burime – marrëveshje tilla konsideroj se duhet drejtuar MPB-së sipas nenit 130 të LPP-së. Ne mbesim pranë vendimit të kërkesës për rishqyrtim, dhe kërkojmë të hedhet ankesa e OE ankues dhe të na lejohet të vazhdojmë me këtë aktivitet.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së, ka deklaruar: Çështja e kritereve të dobëta që cek OE ankues, bazuar në nenin 66 dhe 69 të LPP-së dhe nenit 26 të rregullave të UOPP-së, kjo është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së të specifikoj kritere për kualifikim të OE-ve varësisht prej natyrës së aktivitetit të prokurimit. Një sqarim për pjesëmarrësit, lidhur me këto kritere edhe shoqata ndërmarrjeve që merret me qarkullimin naftës, derivateve të naftës, gazrave dhe lubrifikantëve ka kërkuar nga AQP që disa kritere si licenca për deponim, autorizimi prodhuesit, e disa kritereve të panevojshme të eliminohen nga aktivitet e prokurimit, për arsye se këto kritere kanë minimizuar konkurrencën dhe kanë krijuar favorizim për dy apo tri kompani, kompani të cilat pas aplikimit të këtyre kritereve kanë përfituar pothuajse çdo tender. Në bazë të kësaj shihet se SHQN DGL nuk ka kontestuar kriteret e AK-së , mirëpo ka kërkuar që disa kritere të eliminohen të mos aplikohen për

kualifikim. OE ankues nuk përmendi çështjen e distancës së pikave të karburanteve. AK ka kërkuar sqarim prej Ministrisë së Tregtisë dhe prej AK-KK Mamushë, ku nga ata ka marr konfirmimin se në këtë pjesë operojnë 8 OE. Kështu që për mendimin tim ka OE që mund të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Ky aktivitet është ende në fazën e tenderimit.

Në vazhdim përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: Un kam kontaktuar me drejtorin e licencimeve pranë Ministrisë së Tregtisë, dhe i njëjti me shkrim më ka konfirmuar se me të dhënat ku figuron lista me 8 OE që veprojnë në territorin e Komunës Mamushë. Si pasoj e këtij sqarimi AQP ka hedh poshtë kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. Ne kemi pranuar oferta për këtë aktivitet të prokurimit dhe kemi mundësuar OE-ve që kanë dorëzuar ofertat të modifikojnë ofertat siç parashihet me LPP dhe dosje të tenderit.

Arsyeja pse AQP ka pranuar ofertat është sepse në Udhëzuesin për Prokurime Qendrore thuhet "Në rast se dy OE apo më shumë kanë çmim të njëjtë, atëherë kriter për dhënie të kontratë është ofertuesi që dorëzon i pari tenderi. Kështu thuhet në Udhëzues dhe ne si AK kemi respektuar atë. OE ankues Hib Petrol deri në këtë moment nuk ka dorëzuar ofertë pranë AQP-së , mirëpo ka kohë ende për dorëzim të ofertave. AQP ka publikuar njoftimin për pezullim të aktivitet në platformë të E prokurimit, dhe se afati për dorëzim do caktohet pas pranimit të OSHP-së.

Në pyetje të anëtarit të panelit shqyrtues z. Paçarizi, se a ka pas OE ankues Hib me AQP kontrata për furnizim me derivate?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së deklaroj:Momentalisht OE Hib ka dy kontrata valide në AQP.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti ekspertin shqyrtues se a janë obligative për AK-në vendosjae kritereve që përcakton ligji për natyrën e aktivitetit të prokurimit?

Në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj: Kriteret obligative sipas LPP neni 65 dhe 66 par.1, ndërsa kriteret sipas nenit 68 dhe 69 AK mund ti aplikoj varësisht nga natyra aktivitetit të prokurimit. Mirëpo prapë po e përsëris se kjo është përgjegjësi e AK-së se çfarë kritere vendos në dosje.

Në pyetje se a është i obliguar të vendos kriteret sipas natyrës së prokurimit, në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj; Po AK duhet vendos kriteret sipas natyrës së aktivitetit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar:Bazuar në kritere të dosjes se një OE ka të drejt ofertoj vetëm në dy lote, sipas kritereve të dosjes, ne kemi përgatitur dokumentacionin e plotë për gjithë territorin e Kosovës, që në fund të aplikojmë vetëm në dy llote.

Gjatë marrjes së deklaratave nën betim të sub kontraktorëve që është e obligueshme kemi has në pengesa në disa lokalitete. Ka qenë Mamusha, Kamenica, Juniku. Arsye e mos dhënies deklaratës dhe licencës ka qenë se ja kemi dhënë një OE tjetër dhe nuk të japim ty. Kjo ka qenë arsye pse pretendojmë se ka shkelje territoriale. Njëherit gjatë mbledhjes së deklaratave na kanë njoftuar për krijimin dhe dorëzimin e ofertave te AQP.

Kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së, që aktiviteti i prokurimit të rivlerësoj kushtet për mos krijimin e këtij monopoli, të bëjë anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ritender.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar:Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe mbështesim raportin e ekspertit shqyrtues. Andaj i propozojmë panelit shqyrtues të refuzohet e pabazuar ankesa e OE ankues, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK dhe të vazhdoj AK me këtë aktivitet të prokurimit

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj: ''Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës. 06.02.2017

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe gjatë deklaratave të dhëna në seancën dëgjimore, konstaton se autoriteti kontraktues nuk ka vendosur kërkesa tipike për natyrën e aktivitetit të prokurimit duke ua mundësuar të ofertojnë edhe shumë operatorëve tjerë joprofesional dhe që nuk janë të kualifikuar dhe që nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të përfunduar kontrata të kësaj natyre. Gjithashtu autoriteti kontraktues me qëllim të transparencës dhe trajtimit të barabartë të të gjithë ofertuesve tjerë duhet të ketë parasysh zbatimin e nenit 27/A të LPP-së dhe mundësisë së lejimit të ofertimit në më shumë lote. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e vendosjes së kritereve dhe kërkesave duhet të ketë parasysh nenin 71 të LPP-së, pasi që operatorët ekonomik mund të ofertojnë edhe në grup-konsorcium për të përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, të gjendjes ekonomike financiare dhe të aftësive teknike profesionale. Por çdo herë kërkesat duhet të jenë konform natyrës dhe qëllimit të aktivitetit të prokurimit që zhvillohet.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Agjencia Qendrore e Prokurimit"

1x1 OE "Hib Petrol" Sh.p.k – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.